

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSSH / Departamenti i Matjes dhe Mbështetjes së Tregut / Drejtoria e Menaxhimit të Matjes dhe Kërkesave të Përdoruesve të Rrjetit / Sektori i Menaxhimit të Kërkesave të Përdoruesve.

SPECIALIST

Specialisti i sektorit të Menaxhimit të Kërkesave të Përdoruesve është monitoruesi i një tërësi procesesh të përqëndruara për të ndihmuar në maksimizimin e performancës së proceseve, në mënyrë që të arrihen qëllimet e paracaktuara të kompanisë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Koordinon dhe mbikqyr ndarjen e zonave të leximit, radhës së leximit me qëllim arritjen e efijensës së procesit të leximit.
- Vlerëson/analizon materiale të deleguara nga shefi I sektorit.
- Analizon të dhëna mbi faturim/ndërrprerje në funksion të aplikimit të vendimeve enti rregullator.
- Ndihmon/Jep sugjerime në lidhje me menaxhimin e fluksit të prurjeve në formë shkresore/elektronike.
- Sigurohet që të aplikohen procedurat në përputhje me udhëzimet përkatëse.
- Aplikon në sistem të dhëna sipas procedurës.
- Trajton/ analizon ankesa/ kërkesa të hyra nga Dr. Rajonale/ Furnizues/ Përdorues Rrjeti/ Të tjera.
- Ndryshon status çështje në CRM sipas udhëzimeve dhe procedurave.
- Menaxhon fluksin e çështjeve sipas udhëzimit.
- Analizon rastet e gabimeve në matje sipas planit periodik të testimit sipas udhëzimeve në fuqi.
- Regjistron në sistem rastet e gabimeve në matje.
- Koordinon me njësi në drejtoritë rajonale në lidhje me input dhe output informacion dhe analiza të ndryshme sipas rastit.
- Raporton periodikisht tek eprori e tij mbi mbarëvajtjen e të gjithë proceseve.
- Përgatitjen e procedurave, udhëzimeve, manualeve në bashkëpunim me sektorët, Drejtoritë brenda Departamentit dhe Dr. Rajonale.
- Është gjithmonë I përditësuar me ndryshimet ligjore, rregullatore dhe politikat e kompanisë.
- I orientuar në punën e tij, drejt targeteve dhe objektivave.
- Ndihmon në zhvillimin e procesit.
- Detyra të tjera, të ngarkuara nga Eprori i drejtpërdrejtë.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë Diplomë Universitare.
- Të ketë 3 vite eksperiencë pune.
- Njohuri shumë të mira për sistemet kompjuterike.
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi për të bashkëvepruar me kolegët dhe drejtuesit.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.